

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7149
E shtunë, 23 mars 2024
Çmimi 0.50

O'Brien: Vuçiqi e di se përdorimi i forcës kundër Kosovës do të ishte i papranueshëm | F. 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

PAS DEKLARATËS SË KURTIT, OPOZITA I KËRKON OSMANIT DISKUTIM ME PARTITË PËR SHPËRNDARJEN E KUVENDIT



Kryeministri Albin Kurti ka thënë të premtën se rrëzim të qeverisë nuk do të ketë, por nëse opozita dëshiron zgjedhje të reja, atëherë është i gatshëm të ulet dhe të bisedojnë së bashku për shpërndarjen e Kuvendit. Ndaj

kësaj deklarate ka reaguar lideri i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, i cili i ka kërkuar presidentes Vjosa Osmani të deklarohet për mundësinë për shpërndarjen e Kuvendit si dhe t'i

thërrasë në takim partitë politike për ta diskutuar këtë ndryshim kurs të kryeministrit Kurti. E lideri i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, i ka thënë Kurtit se për shpërndarje të Kuvendit i ka votat e PDK-së

AKTUALE



BLINKENI NË IZRAEL PËR BISEDIME ME NETANYAHUN LIDHUR ME LUFTËN NË GAZË | F. 2

VAZHDON "LUFTA" KUNDËR PARAVE TË FALSIFIKUARA | F. 6

CERTIFIKOHEN 56 KANDIDATË QË KANË KALUAR PROVIMIN E NOTERISË | F. 6

EKONOMI



ODA EKONOMIKE AMERIKANE REAGON LIDHUR ME NDËRHYRJET POLITIKE NDAJ INSTITUCIONEVE TË DREJTËSISË | F. 8

KDI-ja PËR KOMISIONIN HETIMOR PËR REZERVA: E PËRFUNDUI MANDATIN ENDE PA E FILLUAR PUNËN | F. 8

SPORT



FODA DEBUTON ME FITORE TE KOSOVA, SHOIPËRIA MPOSHTET NGA KILI | F. 10

54 % E QYTETARËVE I VLERËSOJNË TË DREJTA VENDIMET E KUSHTETUESËS PËR LIGJET QË SYNOJNË REFORMA NË DREJTËSI | F. 3



HOVENIERI: NGA QEVERIA E KOSOVËS PRESIM TË PUNOJË NË PARTNERITET ME NE | F. 5



RENOVA
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
PUTZ
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mobi: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVE
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

BE-ja me tarifa synon "t'i ngufasë" të ardhurat ruse

BRUKSEL, 22 MARS - Bashkimi Evropian po synon "t'i ngufasë" të ardhurat e Rusisë të cilat i përdor në luftën kundër Ukrainës, duke vendosur "tarifa ndaluese" ndaj drithërave dhe importet e tyre në bllok, tha komisionari evropian për Tregti më 22 mars. Propozimi nga Komisioni Evropian po shqyrtohet nga udhëheqësit e BE-së, të cilët po zhvillojnë një samit në Bruksel.

Sanksionet e reja, që u mirëpritën nga Kiev, nuk do të aplikoheshin ndaj drithërave ruse që kalojnë përmes BE-së për në tregje të tjera, në mënyrë që të mos shkaktohen pengesa për furnizim në vende të tjera, tha komisionari për Tregti, Vladis



Dombrovskis. Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky është ankuar ndaj udhëheqësve evropianë të premtën, kur foli në samit

përmes videolidhjes. Ai tha se nuk është e drejtë që drithërat ruse të kenë qasje të pakufizuar në tregjet evropiane në kohën kur importet ukrainase po

kufizohen. Brukseli ka kërkuar ta risë presionin ndaj ekonomisë ruse pas vendosjes të disa raundeve të sanksioneve që veçse kanë ngrirë asetet ruse në 27 shtetet e bllokut, kanë shënjestruar udhëheqësit rusë, përfshirë presidentin Vladimir Putin, dhe kanë tkurrur tregtinë. Një ditë më parë presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, tha se tarifatat e propozuara do të pamundësonin që "drithërat ruse ta destabilizojnë tregun e BE-së me këto produkte". Komisionari Dombrovskis gjatë së premtës tha se "propozimi i sotëm është në kohën e duhur dhe është hap i nevojshëm". Ai

tha se tarifatat do të vendosen ndaj produkteve nga Bjellorusia, shtet që ka lejuar përdorimin e territorit të tij që Rusia ta niste pushtimin e Ukrainës më 2022. Propozimi vjen pasi, sipas Komisionit Evropian, më 2023 ka pasur rritje të importeve bujqësore ruse në BE.

Dombrovskis tha se këto tarifa do të bënin që importet ruse të ishin "të paqasshme" në tregje dhe do të ndihmonin që të ndalohej praktika ruse "e eksportimit të paligjshëm të drithërave të vjedhura ukrainase për në BE". Sipas rregullave të Organizatës Botërore të Tregtisë, të gjitha drithërat ruse deri më tani janë përjashtuar nga taksat e importit në BE.

Blinkeni në Izrael për bisedime me Netanyahu lidhur me luftën në Gazë

JERUSALEM, 22 MARS - Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, po qëndron në Izrael për ato që pritet të jenë bisedime të ashpra me kryeministrin izraelit, Benjamin Netanyahu, lidhur me luftën në Gazë, teksa dallimet publike rreth konfliktit janë thelluar. Kjo është ndalesa e fundit e Blinkenit në misionin e tij të gjashtë diplomatik në Lindjen e Mesme, në të cilin ai pritet të takohet me Netanyahu dhe kabinetin e tij të luftës, me synimin që t'i bindë ata të mos zbatojnë planet e tyre për një ofensivë ushtarake në qytetin jugor të Rafahut.

Një ofensivë në shkallë të gjerë në Rafah ka rritur frikën se mund ta përkeqësojë edhe më shumë krizën e thellë humanitare në Rripin e Gazës. "Një operacion i madh ushtarak

në Rafah do të ishte gabim dhe është diçka që ne nuk e mbështesim", tha një ditë më parë Blinken gjatë qëndrimit në Kajro, ku u takua me kryediplomatët nga Egjipti, Jordania, Arabia Saudite, Katari dhe Emiratet e Bashkuara Arabe. Blinken pritet t'i paraqesë Netanyahu alternativa për ta luftuar Hamasin - grupin palestinez të shpallur organizatë terroriste nga ShBA-ja dhe Bashkimi Evropian - në Rafah. Bisedimet do të vazhdojnë edhe në javën tjetër kur ministri izraelit i Mbrojtjes, Yoav Gallant, dhe një delegacion i ndarë i zyrtarëve të lartë izraelitë, do ta vizitojnë Uashingtonin. Netanyahu u pajtua për vizitën e këtij delegacioni gjatë një bisede telefonike që zhvilloi të hënën me presidentin amerikan Joe



Biden. Kjo ishte biseda e parë në muajin e fundit mes udhëheqësve në mes të thellimit të dallimeve.

Vizita e Blinkenit nuk ishte paralajmëruar kur kryediplomati amerikan nisi turneun e tij në Lindjen e Mesme. Kjo vizitë vjen pasi zyrtarët e lartë të inteligjencës nga ShBA-ja, Izraeli, Egjipti dhe Katari pritet të takohen në Doha për të diskutuar për detajet e një marrëveshjeje armëpushimi, që parashihet edhe lirin e pengjeve.

Hamas, gjatë sulmit të 7 tetorit në jug të Izraelit - sulm që nxiti luftën - vrau afër 1 200 persona, shumica civilë dhe rrëmbeu afër 250 të tjerë.

Si pasojë e ofensivës tokësore dhe ajrore të Izraelit, në Rripin e Gazës janë vrarë afër 32 000 persona, shumica gra dhe fëmijë, sipas Ministrisë së Shëndetësisë, në enklavën e udhëhequr nga Hamas.

Kremlini për herë të parë thotë se Rusia është "në luftë" me Ukrainën

MOSKË, 22 MARS - Rusia tani është "në luftë" me Ukrainën për shkak të ndërhyrjes perëndimore, në atë që Moskë më herët e ka quajtur "operacion të posaçëm ushtarak", tha për agjencinë Argumenty i Fakty (AiF), zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov. "Ne jemi në luftë. Në të vërtetë, nisi si një operacion i posaçëm ushtarak, por sapo u krijua një klikë dhe Perëndimi kolektiv u bashkua në krahun e Ukrainës, kjo për ne u shndërrua në luftë. Jam i bindur për këtë. Të gjithë duhet ta kuptojnë këtë në mënyrë që të mbledhin forcat", citohet të ketë thënë Peskov. Që nga nisja e pushtimit në shkallë të gjerë të Ukrainës në shkurt të

vitit 2022, Kremlini ka shmangur që ta quajë konfliktin luftë dhe i është referuar si "operacion i posaçëm ushtarak". Kremlini, po ashtu, ka shtyrë përpara ligje të reja përmes Dumës Shtetërore, sipas të cilave, cilësimi i konfliktit si "luftë" është ilegal dhe shumë njerëz janë gjobitur e burgosur për "diskreditimin" e forcave ruse dhe përhapjen "e informacioneve të rreme" për shkak të përdorimit të kësaj fjale. Gjatë këtij deklariimi, Peskov shtoi se Rusia duhet t'i "çlirojë" krejtësisht "rajonet e saj të reja" - katër rajonet në Ukrainë që Moskë ka aneksuar paligjshëm gjatë luftës - për "ta mbrojtur popullin në këto

rajone dhe për ta çliuar territorin e këtyre rajoneve".

Moska ka aneksuar ilegalisht rajonet pas nisjes së pushtimit, megjithëse mbetet e paqartë se sa territor ka nën kontroll.

Deklaratat e Peskovit u bënë pasi presidenti rus Vladimir Putin fitoi me lehtësi zgjedhjet presidenciale të fundjavës së kaluar, votime që, sipas vëzhguesve të pavarur, nuk ishin as të lira, e as fër. Këto ishin zgjedhjet e para të mëdha në Rusi që kur Putin nisi pushtimin në shkallë të plotë të shtetit fqinj. Sipas rezultateve zyrtare, Putini siguroi një mandat të ri gjashtëvjeçar presidencial, pasi fitoi 87.3 për qind të votave.



54 % e qytetarëve i vlerësojnë të drejta vendimet e Kushtetueses për ligjet që synojnë reforma në drejtësi

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 22 MARS - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka mbajtur të premten konferencë për medie, në të cilën ka paraqitur rezultatet e hulumtimit të opinionit publik, me theks këndvështrimet e qytetarëve të Kosovës mbi ecurinë e reformës në sektorin e drejtësisë. Gjatë shpalosjes së të dhënave, Violeta Haxholli nga KDI-ja ka thënë se përmes këtij sondazhi është synuar të kuptohen disa çështje, duke filluar me atë se si e shohin qytetarët qasjen e qeverisë dhe subjekteve opozitare ndaj procesit të reformës në drejtësi, si i kanë parë vendimet e Gjykatës Kushtetuese rreth ligjeve të cilat tentojnë ta reformojnë sistemin e drejtësisë dhe çfarë pritjesh kanë nga ky proces.

Në pyetjen drejtuar qytetarëve se si e vlerësojnë qasjen e qeverisë ndaj reformës në drejtësi, 49 % janë të mendimit se qeveria me anë të reformës po synon fuqizimin e sundimit të ligjit, kundrejt 22 % të qytetarëve që



mendojnë se qeveria me anë të reformës po synon ndërhyrjen në sektorin e drejtësisë. 18 % e tyre mendojnë se qeveria po shpërfillë aktorët e tjerë gjatë procesit të hartimit të ligjeve. Kur janë pyetur se cilat mund të

janë arsytet e subjekteve opozitare për t'i dërguar ligjet e reformës në Gjykatën Kushtetuese, 31 % e tyre kanë thënë se opozita i ka dërguar ligjet në gjykatë për shkak të cilësorisë së dobët të tyre, ndërsa 31 % e tyre

janë shprehur se kjo po bëhet për t'i shmangur mundësitë e ndërhyrjeve të qeverisë në organet e drejtësisë. Në anën tjetër, 25 % e qytetarëve mendojnë se opozita i ka dërguar ligjet në gjykatë për shkak se

ndihet e kërcënuar nga reforma në drejtësi, kundrejt 17 % të tyre që mendojnë se me anë të këtij veprimi opozita po pengon reformën.

Në pyetjen se si i shohin qytetarët vendimet e Gjykatës Kushtetuese lidhur me ligjet e reformës në drejtësi, 54 % e qytetarëve janë shprehur se atkgjykimet e Gjykatës Kushtetuese janë të drejta, kundrejt 24 % të tyre që i konsiderojnë të padrejta. Ndërsa nuk kanë ofruar përgjigje 21 % prej tyre.

Në fund, qytetarët janë pyetur edhe rreth pritjeve të tyre nga procesi i reformës në drejtësi. 41 % e tyre janë përgjigjur se presin që reforma ta fuqizojë sundimin e ligjit, ndërsa 30 % e tyre se reforma do ta përmirësojë punën e gjykatave dhe prokurorive. Në anën tjetër, 28 % e qytetarëve të anketuar nuk presin ndryshime nga reforma në drejtësi.

Ky hulumtim i opinionit publik është realizuar me metodën e Omnibusit, në të cilin kanë marrë pjesë 1 065 respondentë të moshës mbi 18 vjeç. Periudha e anketimit përfshin datën nga 4 deri më 15 mars 2024.

O'Brien: Vuçiqi e di se përdorimi i forcës kundër Kosovës do të ishte i papranueshëm



PRISHTINË, 22 MARS - Ndhimëssekretari amerikan i Shtetit për Evropën dhe Euroazinë, James O'Brien, ka thënë se Shtetet e Bashkuara janë duke i vëzhguar lëvizjet e ushtrisë serbe afër kufirit me Kosovën dhe se Shtetet e Bashkuara ia kanë bërë me dije Serbisë se përdorimi i forcës do të ishte i papranueshëm. Ai ka thënë se një lëvizje eventuale prej forcave të Serbisë do të konsiderohej prej ShBA-së rrezikim i forcave të

NATO-s "që janë në Kosovë për t'i mbrojtur shqiptarët dhe serbët". Sipas tij, presidenti serb Aleksandër Vuçiq ka thënë se nuk do të ketë përdorim të forcës, raporton REL. O'Brien i ka bërë këto deklarata në një bashkëbisedim online me gazetarët. Ai ka thënë, po ashtu, se Serbisë i është bërë e qartë që personat e përfshirë në sulmin e 24 shtatorit të vitit 2023 në Banjskë të Zveçanit duhet të mbahen përgjegjës.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë më 21 mars se njësi të ushtrisë serbe janë vërejtur disa metra larg kufirit me Kosovën dhe i ka cilësuar këto lëvizje si "provokime të qëllimshme". "Ditë më parë, presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, kërcënoi publikisht Kosovën, duke thënë se 'Serbia do të presë momentin më të mirë të mundshëm dhe do ta shfrytëzojë mundësinë të veprave'. Sot gjatë ditës njësi të specializuara të ushtrisë së Serbisë janë vërejtur

vetëm disa metra larg kufirit me Kosovën, në afërsi të fshatit Banjë të Zubin Potokut. Lëvizje të ngjashme janë regjistruar edhe në fshatin Oslare të Bujanovcit, në afërsi të kufirit me Kosovën. Jemi të vetëdijshëm se Forcat e Armatosura të Serbisë janë duke realizuar stërvitjet e rregullta dhe ato janë duke i përdorur si pretekst për të shkaktuar provokime të qëllimshme në afërsi të kufirit me Kosovën. Jemi duke vëzhguar me kujdes se a do të përpiqen ta

kalojnë kufirin, gjersa edhe ky afrim i automjeteve të tyre ushtarake nuk është normal", ka thënë Kurti.

Të premten Ministria e Mbrojtjes e Serbisë i ka quajtur deklaratat e Kurtit pjesë e fushatës dezinformuese për ushtrinë e Serbisë. Sipas saj, forcat e ushtrisë serbe janë duke i kryer detyrat e tyre në zonën e sigurt administrativ në përputhje me të gjitha marrëveshjet e nënshkruara.



Pas deklaratës së Kurtit, opozita i kërkon Osmanit diskutim me partitë për shpërndarjen e Kuvendit

Kryeministri Albin Kurti ka thënë të premten se rrëzim të qeverisë nuk do të ketë, por nëse opozita dëshiron zgjedhje të reja, atëherë është i gatshëm të ulet dhe të bisedojnë së bashku për shpërndarjen e Kuvendit. Ndaj kësaj deklaratë ka reaguar lideri i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, i cili i ka kërkuar presidentes Vjosa Osmani të deklarohet për mundësinë për shpërndarjen e Kuvendit si dhe t'i thërrasë në takim partitë politike për ta diskutuar këtë ndryshim kursi të kryeministrit Kurti. E lideri i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, i ka thënë Kurtit se për shpërndarje të Kuvendit i ka votat e PDK-së

qeverinë”, ka thënë Kurti në një konferencë për medie, në të cilën ka folur për trevjetorin e qeverisjes së tij. Ai ka thënë se dëshira e tij është që ta vazhdojë qeverisjen. “Dorëheqje nuk jap”, ka thënë Kurti.

Ndaj deklaratës së Kurtit ka reaguar të premten ish-kryeministri dhe lideri i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, i cili i ka kërkuar presidentes Vjosa Osmani të deklarohet për mundësinë për shpërndarjen e Kuvendit si dhe t'i thërrasë në takim partitë politike për ta diskutuar këtë ndryshim kursi të kryeministrit Albin Kurti. “Aleanca ka kohë që ka kërkuar mocion mosbesimi ndaj qeverisë, mirëpo kryeministri jo vetëm që e ka kundërshtuar, por është kujdesur të na e kujtojë se kur është afati i zgjedhjeve të rregullta. Tash paska dalë me kërkesë që të bashkohet me opozitën për ta shpërndarë Kuvendin. Çka ka ndryshuar në ndërkohë!? A është presidentja e vendit në dijeni për këtë ndryshim kursi të kryeministrit? Shpërndarja e Kuvendit duhet të jetë rezultat i një konsensusi

politik. Presidentja duhet të deklarohet për këtë çështje dhe eventualisht t'i thërrasë në takim partitë politike, për ta diskutuar këtë ndryshim kursi të kryeministrit. Kosova sot përballet me një situatë të ndjeshme, edhe politike edhe të sigurisë, dhe kjo temë kërkon qartësi. Përpos nëse edhe ky ndryshim kursi i Albin Kurtit, është veç edhe një mashtrim i radhës”, ka shkruar Haradinaj në “Facebook”.

Edhe lideri i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, ka thënë se partia që drejton prej vitit të kaluar ka bërë thirrje të shpërndahet Kuvendi. “Kryeministër, prej korrikut të vitit të kaluar të kam bërë thirrje e të kam pritë që me shpërnda Kuvendin. Prej nesër nënshkrimet e PDK-së janë gati. Çohu shkojmë në zgjedhje menjëherë - nëse ke guxim e të ka mbetur pak ndërgjegje për situatën e vështirë që e ke sjellë vendin!”, ka shkruar Krasniqi në “Facebook”.

Rrëzimin e qeverisë Kurti e ka kërkuar në vazhdimësi edhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK).

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 22 MARS - Kryeministri Albin Kurti ka përsëritur sërish të premten se nëse opozita dëshiron zgjedhje të reja, atëherë është i gatshëm të ulet dhe të bisedojnë së bashku për shpërndarjen e Kuvendit, por ka thënë se rrëzim të qeverisë nuk do të ketë. “Nuk kam deklaruar ashtu, por i jam përgjigjur pyetjes së gazetares. Shtrohet pyetja pse më ka pyetur gazetaria. Ajo më ka pyetur sepse ka presupozuar

dëshirën e opozitës. Nëse nuk do të kishte dëshirë të opozitës, nuk do të kishte pyetje të gazetares dhe, rrjedhimisht, nuk do të kishte përgjigje timen. Pra, gjithçka ndërtohet mbi hipotezën që opozita dëshiron zgjedhje të parakohshme dhe unë kam shprehur gatishmërinë time që nëse opozita dëshiron zgjedhje të parakohshme, mund ta bëjmë me 2/3 e votave të Kuvendit shpërndarjen e Kuvendit dhe të shkojmë në zgjedhje. Nëse opozita është rehat, ne jemi edhe më rehat. Pra, ne po qeverisim

mbarë e mirë dhe këto janë të arriturat. Jemi rehat në punën që bëjmë. Pra, vetëm nëse opozita do zgjedhje, ne jemi të gatshëm të ulemi e të bisedojmë për shpërndarjen e Kuvendit dhe të shkojmë në zgjedhje, por nuk ka pse të rrëzohet qeveria. Qeveria e mbarë e mirë nuk rrëzohet. Qeveria vazhdon, mirëpo nëse opozita është e interesuar që të mos i kemi ne 12 muaj në vitin e fundit, por të kemi më pak muaj, atëherë jemi të gatshëm të ulemi dhe ta bëjmë shpërndarjen e Kuvendit, por jo ta rrëzojmë

Hovenieri: Nga Qeveria e Kosovës presim të punojë në partneritet me ne

PRISHTINË, 22 MARS - Ambasadori amerikan në Prishtinë, Jeff Hovenier, ka thënë të premten se pret nga Qeveria e Kosovës, e udhëhequr nga kryeministri Albin Kurti, të punojë në partneritet me Uashingtonin, në mënyrë që në Kosovë të ketë përparime.

Në një konferencë të organizuar nga Këshilli i Ambasadorëve të Kosovës për 25-vjetorin e ndërhyrjes ushtarake të NATO-s, që i dha fund luftës së fundit, Hovenieri përsëriti qëndrimin amerikan se rruga e vetme e Kosovës drejt integriteteve euroatlantike është dialogu për normalizimin e raporteve me Serbinë që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian. "Nuk ka rrugë tjetër dhe posaçërisht zbatimi në mirëbesim dhe i plotë i të gjitha zotimeve që janë bërë nga Kosova në dialog, kjo nuk është e negociueshme. Nga kjo Qeveria e Kosovës, ashtu sikurse edhe nga qeveritë paraprake, presim që të punojë në partneritet me ne, derisa vazhdojnë përpjekjet tona për të ndërtuar një Kosovë prosperuese, multietnike dhe të sigurt në rajonin e Ballkanit Perëndimor", ka thënë Hovenieri. Kosova dhe Serbia që nga viti 2011 zhvillojnë dialog politik, që synon normalizimin e raporteve mes shteteve. Gjatë procesit janë arritur shumë marrëveshje, por pak prej tyre zbatohen në terren. Vitin e fundit palët u pajtuan për Marrëveshjen në rrugën drejt normalizimit por, sipas Bashkimit Evropian, Prishtina dhe Beogradi nuk po e zbatojnë të njëjtën. ShBA-ja, që mbështet dialogun e Brukselit, vazhdimisht u kërkon palëve t'i zbatojnë të gjitha marrëveshjet e dialogut. Raportet në mes të Kosovës dhe



ShBA-së janë tendosur së fundi për shkak të vendimit të autoriteteve të Kosovës për ta ndaluar përdorimin e dinarit serb. Zyrtarët amerikanë kanë kërkuar që Kosova ta shtyjë zbatimin e vendimit, duke thënë se kjo çështje ka paraqitur sfida në raportet dypalëshe.

I dërguari i ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka thënë se me mospërbushjen e kërkesës amerikane për çështjen e dinarit, Qeveria e Kosovës nuk po e trajton Uashingtonin si partner. Ndërkaq, duke kujtuar ndërhyrjen para një çerek shekulli

të NATO-s në Kosovë, për t'i dhënë fund, siç tha ai, "spastrimit etnik" në Kosovë nga "makineria [e udhëheqësit të atëhershëm serb, Slllobodan] Millosheviqit", Hovenieri tha se shteti i tij është i përkushtuar që ngjarje të tilla të mos përsëriten. "Dua ta riafirmoj përkushtimin tonë drejt sigurimit

që ngjarjet e tmerrshme që kanë ndodhur para 25 vjetësh në Kosovë të mos ndodhin më kurrë. Mbesim të përkushtuar që ta mbështesim rolin stabilizues që luhet nga forca e NATO-s, KFOR", është shprehur Hovenieri, duke theksuar se ndërhyrja e NATO-s ishte edhe e domosdoshme, edhe legjitime, "duke marrë parasysh krizën humanitare që bota po shihte në kohë reale".

Më 24 mars bëhet një çerek shekulli nga nisja e sulmeve ajrore të Aleancës Veri-Atlantike kundër caqeve ushtarake policore në ish-Jugosllavi.

Pas 78-ditësh të sulmeve, bombardimet u ndërprejnë më 10 qershor 1999, me miratimin e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

Kjo Rezolutë ishte një kompromis i pesë vendeve të përhershme anëtare të Këshillit të Sigurimit në bazë të së cilës, në Kosovë vendosej një administratë e Kombeve të Bashkuara, UNMIK, e cila administronte fazën transitore deri në ngritjen e institucioneve vendore dhe zgjidhjen e përhershme të statusit të Kosovës.

Ndërhyrja ushtarake e NATO-s në Kosovë mundësoi kthimin në shtëpitë e tyre të më shumë se 800 000 personave të zhvendosur brenda dhe jashtë Kosovës.

Më 12 qershor 1999 në Kosovë filloi vendosja e rreth 50 000 ushtarëve nga 36 vende të botës, prej të cilëve 30 000 ishin nga vendet e NATO-s.

Njëzet e pesë vjet pas kësaj ndërhyrjeje, në misionin paqeruajtës të NATO-s në Kosovë, KFOR, ka numër shumë më të vogël të ushtarëve, 4 700 sosh.

KFOR-i u bënë thirrje Kosovës dhe Serbisë të përmbahen nga retorika përshkallëzuese

PRISHTINË, 22 MARS - Misioni paqeruajtës i NATO-s në Kosovë, KFOR, ka thënë të premten se gjendja e sigurisë në Kosovë është "e qetë, por e brishtë", si dhe u ka bërë thirrje Kosovës dhe Serbisë të përmbahen nga retorika përshkallëzuese dhe ndarëse. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha të enjten vonë se njësi të ushtrisë serbe janë vërejtur disa metra larg kufirit me Kosovën, duke i cilësuar ato lëvizje si "provokime të qëllimshme".

Në një përgjigje për Radion Evropa e Lirë (REL), KFOR-i tha se, pas tensioneve të fundit, rreth 1 000 trupa shtesë të misionit janë zhvendosur në Kosovë dhe se prania e kësaj force në veri të Kosovës është rritur. "Ne e kemi trefishuar edhe numrin e patrullimeve, përfshirë në vijën



kufitare administrative", tha KFOR-i. "Qëllimi ynë është ta ndalojmë përshkallëzimin dhe ne jemi të

gatshëm dhe të pajisur për t'i ndërmarrë të gjitha masat për ta përmbushur mandatin tonë të

OKB-së, për të siguruar mjedis të sigurt për të gjithë njerëzit që jetojnë në Kosovë, si dhe lëvizjen e lirë,

shtoi ai.

Të premten më herët, Ministria e Mbrojtjes e Serbisë i hodhi poshtë deklaratat e Kurtit duke i cilësuar "fushatë dezinformuese për ushtrinë e Serbisë". Ajo tha se forcat e ushtrisë serbe "janë duke i kryer detyrat e tyre në zonën e sigurt administrative në përputhje me të gjitha marrëveshjet e nënshkuara". KFOR-i tha se prania e misionit të saj është "fleksibile dhe e dukshme" në gjithë Kosovën, duke shtuar se kjo ia mundëson asaj ta vëzhgojë nga afër çfarëdo zhvillimi relevant të sigurisë dhe të përgjigjet ndaj të gjitha situatave që kanë ndikim në sigurinë.

Forca paqeruajtëse tha se është duke punuar afër me Policinë e Kosovës dhe EULEX-in, si reagues të parë dhe të dytë të sigurisë në Kosovë.

Vazhdon "lufta" kundër parave të falsifikuara

PRISHTINE, 22 MARS - Falsifikimi i parasë është një ndër veprat më të vjetra kriminale dhe paraqet rrezik dhe bregë për të gjitha vendet pa përjashtim. Me qëllim të ruajtjes së integritetit të parasë në qarkullim, lufta kundër kësaj dukurie është një aktivitet i përditshëm i të gjitha institucioneve përgjegjëse pa përjashtuar këtu edhe publikun e gjerë.

Në fund të vitit 2023 Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka koordinuar me sukses takime ndërinstitucionale për të hartuar dhe zbatuar strategji efektive për luftimin e qarkullimit të monedhave të falsifikuara, veçanërisht monedhave dy euro. "Përmes masave të qarta dhe veprimeve të koordinuara, si heqja e tarifave për deponimin e monedhave, sigurimi i furnizimit të ekonomisë me monedha të reja përmes bankave komerciale dhe ndryshimet rregullative të transportit ndërkufitar të monedhave, është arritur të tërhiqen nga qarkullimi sasi e konsiderueshme e monedhave të falsifikuara", ka njoftuar BQK-ja. Konkretisht nga dhjetori 2023

deri në mars 2024 janë tërhequr nga qarkullimi dhe deponuar në BQK rreth dy milionë copë monedha të denominimeve prej 2 eurosh, monedha këto të deponuara nga bizneset dhe qytetarët në bankat komerciale. Po ashtu, BQK-ja dhe bankat komerciale kanë detektuar dhe parandaluar hyrjen në sistemin financiar, duke i tërhequr nga qarkullimi rreth 47 168 copë monedha të denominimeve prej 2 eurosh, të dyshuara si të falsifikuara. BQK-ja ka furnizuar ekonominë e Republikës së Kosovës përmes bankave komerciale me afër 6.75 milionë copë monedha euro plotësisht të reja të të gjitha denominimeve pa asnjë tarifë të aplikuar. Ky angazhim ka kontribuar në zvogëlimin e qarkullimit të monedhave false, ka lehtësuar identifikimin dhe ka ngritur ndërgjegjësimin e publikut për këtë çështje. "Në zbatim të masave rregullative, përmes Rregullores për Operacione me Para të Gatshme, sa i përket rregullimit të transportit ndërkufitar të monedhave me qëllim të parandalimit të futjes së parave të falsifikuara, personat fizikë dhe personat juridikë që nuk ushtrojnë veprimtari financiare



janë të obliguar që të bëjnë deklarimin e monedhave nëse bartin më shumë se 100 copë/njësi, pavarësisht që vlera e tyre është nën kufirin e deklarimit prej 10,000 (dhjetë mijë) euro. Gjithashtu, si rezultat i masave përkatëse, deri më tani numri i kartëmonedhave prej 500 (pesëqind) euro të tërhequra nga qarkullimi dhe deponuara në BQK ka kaluar mbi 230,000 (dyqind e tridhjetë mijë) copë/njësi apo mbi 115 (njëqind e pesëmbëdhjetë) milionë euro. Ky veprim, përveç që ka ndikuar aspektin e reduktimit të rrezikut të parave të falsifikuara, ka kontribuar dhe ndihmuar në strategjinë përkatëse kundër informalitetit dhe dukurive të

ndërlidhura", ka njoftuar BQK-ja. BQK-ja ka njoftuar se po vazhdon t'i nxitë qytetarët dhe bizneset t'i deponojnë monedhat e tyre në bankat komerciale pa kosto dhe çdo dyshim për tentim të futjes në qarkullim të parave të falsifikuara nga falsifikatorët ta raportojnë tek autoritetet përgjegjëse. "Po ashtu, bizneset nxiten që të furnizohen me monedha vetëm përmes bankave komerciale dhe të shmangin kanalet jozyrtare. Prandaj, BQK-ja ripërsërit qëndrimin dhe rekomandon që të shmangjet sa më shumë përdorimi i parasë së gatshme në pagesa elektronike dhe kartelave bankare; Të tregohet vëmendje e

veçantë ndaj monedhave të pranuar; Bankat dhe institucionet financiare jobankare të promovojnë pagesat elektronike dhe shtrijnë rrjetin e pajisjeve për pagesa me kartela bankare; Bizneset të cilat pranojnë para të gatshme të shtojnë përpjekjet e tyre duke investuar në teknologjitë që bëjnë detektimin e parave të falsifikuara dhe lëvizin drejt reduktimit të parasë së gatshme si mjet pagese; dhe Qytetarët në bazë të ligjit të raportojnë te autoritetet përgjegjëse (Policia e Kosovës) çdo dyshim për tentim të futjes në qarkullim të parave të falsifikuara nga falsifikatorët. BQK-ja rikonfirmon angazhimin e saj të plotë për të mbështetur çdo përpjekje për të luftuar kundër parave të falsifikuara dhe nxiti vazhdimin e masave parandaluese dhe edukative. "Gjithashtu, shpreh mirënjohjen e thellë ndaj të gjithë qytetarëve dhe bizneseve që kanë kontribuar dhe ndihmuar në këto aktivitete të luftës ndaj këtij fenomeni, krahas institucioneve shtetërore përgjegjëse dhe bashkëpunuese në këto përpjekje, që me gjithë rezultatet pozitive, duhet të vazhdojnë dhe janë sfida të përhershme", ka njoftuar BQK-ja.

Trajnimit me DTRA-n, certifikohen ushtarët nga Maqedonia e Veriut dhe FSK-ja

PRISHTINE, 22 MARS - Në ambientet e Gardës Kombëtare është mbajtur ceremonia e përfundimit të trajnimit të përbashkët të pjesëtarëve të njësive Hazmat të FSK-së dhe të njësive CBRN të Forcave të Republikës së Maqedonisë së Veriut me Agjencinë për Reduktimin e Kërcënimeve të Mbrojtjes (Defense Threat Reduction Agency, DTRA), U. S. Marines CBIRF dhe Skuadrën e 71-të të Mbështetjes të Gardës Kombëtare të Lovës (71st Civil Support Team). Gjatë këtij trajnimit që është zhvilluar në Qendrën Ndërkombëtare Trajnuese për Kërkim-Shpëtim në Pomozatin, njësitë e Regjimentit të Mbrojtjes Civile, Kompania e Materieve të Rrezikshme kanë shkëmbyer përvoja me pjesëtarët e ushtrisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për kapacitetet, mënyrën e operimit në terren si dhe përdorimin e pajisjeve



specialistike. Po gjatë këtij ushtrimit pjesëtarët tanë dhe pjesëtarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut janë testuar në simulime të organizuara nga instruktorët amerikanë. Simulimet ishin të ndryshme dhe komplekse, duke përfshirë fushën kimike, biologjike dhe radiologjike. Ky trajnim ishte një mundësi shumë e mirë për pjesëtarët që të

shkëmbejnë përvoja të ndryshme, operacione, intervenime reale nga pjesëtarët dhe instruktorët pjesëmarrës. Ministrit i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ka theksuar se ambienti aktual i sigurisë në botë dhe regjion po dëshmon qartë se sa i rëndësishëm ka qenë dhe mbetet bashkëpunimi i FSK-së me DTRA. "Kërcënimet nga aktorët e rinj dhe të vjetër, me prirje autokratike dhe me qasje

hegemoniste dhe agresive, nuk po e sfidojnë vetëm rendin e ri botëror, por edhe rregullat e luftës të përcaktuara në ligjin humanitar ndërkombëtar. Në këtë aspekt rreziku i përdorimit të armëve të shkatërrimit në masë dhe agjentëve kimikë dhe biologjikë është më i lartë se kurrë. Duke i shtuar kësaj rreziqet që përcjellin zhvillimin e gjithëmbarshtëm industrial dhe teknologjik, mirëmbajtja dhe zhvillimi i kapaciteteve të mbrojtjes nga materiet e rrezikshme është domosdoshmëri, siç është domosdoshmëri bashkëpunimi në mes të partnerëve regionalë për t'u përballur me këtë sfidë të kohëve moderne", ka theksuar ai. Maqedonci ka pohuar se Republika e Kosovës, Forca e Sigurisë së Kosovës, në veçanti Garda Kombëtare, ndër vite, përveç përvojës së fituar nga trajnimet, nga programi i DTRA-s i Shteteve të Bashkuara ka

pranuar pajisje me vlerë mbi 2 milionë dollarë, gjë që i ka mundësuar këtij kapaciteti tonë të jetë ndër kapacitetet më profesionale dhe kompetente që ka Republika e Kosovës. "Pjesëmarrja e ushtarakëve nga Maqedonia e Veriut është vlerë e shtuar dhe unike për ushtrimin dhe tregon për përkushtimin e përbashkët për paqen, stabilitetin dhe sigurinë e qytetarëve të regjionit tonë. Trajnimi nga instruktorë amerikanë dhe shkëmbimi i përvojave në mes të pjesëtarëve të dy vende tona gjatë këtij ushtrimit me skenarë realë dhe kompleksë, jam i bindur plotësisht që ju ka ndihmuar jo vetëm për t'i rritur aftësitë tuaja individuale për t'i kryer detyrat specialistike, por edhe për të ndërvepruar kur kërkohet nga ju", ka deklaruar Maqedonci. Në përfundim të ceremonisë u shpërndanë certifikata për pjesëtarët e trajnuar.

Certifikohen 56 kandidatë që kanë kaluar provimin e Noterisë

PRISHTINE, 22 MARS - 56 kandidatët që kanë kaluar provimin e Noterisë të premtën kanë pranuar certifikatat për dhënie e këtij provimi nga ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, në një ceremoni zyrtare. Ministrja Haxhiu në fjalën e saj përshëndetëse tha se kjo ceremoni po ndodh pas një rrugëtimi të gjatë përpjekjesh për mënjanimin e proceseve të mëhershme, por të dëmshme për t'i pranuar si të

mirëqena, duke potencuar më tej se ndihet krenare që gjendet pranë kandidatëve që kanë dhënë provimin e Noterisë, ballëhapur dhe e vetëdijshme se ky proces ka qenë procesi më meritor dhe transparent ndonjëherë. Më tej, Haxhiu falënderoi komisionin e emëruar për punën e bërë dhe vendosjen e standardeve të larta në këtë proces meritor dhe transparent, për çka tha se është vlerësuar pozitivisht

edhe nga monitoruesit vendorë dhe ndërkombëtarë, për të njoftuar në fund se shumë shpejt Ministria e Drejtësisë do të shpallë pozita të lira për noterë në tërë territorin e Republikës së Kosovës, në të gjitha komunat, përfshirë këtu për herë të parë edhe komunat me shumicë serbe në veri të vendit, për ta shtrirë kështu shërbimin noterial deri ku shtrihet sovraniteti i Republikës.



Arrestohet një person për falsifikim të dokumentit, parandalohen edhe dy raste të kontrabandës së mallrave

Prishtinë, 22 mars - Policia kufitare ka iniciuar tri raste: ka arrestuar një person për falsifikim të dokumentit dhe ka parandaluar dy raste të kontrabandës së mallrave. “Dje më 21.03.2024, në ora 14:25, në Aeroportin e Prishtinës, është arrestuar i dyshuari mashkull shtetas i Maqedonisë së Veriut, pasi që i njëjti në kontroll të dokumenteve ka prezantuar pasaportën sllovene me emër të një personi tjetër dhe që dyshohet të jetë i falsifikuar. Dokumenti i dyshuar është

sekustruar. Me vendim të prokurorit i dyshuari është dërguar në mbajtje”, ka njoftuar Policia e Kosovës, duke dhënë edhe hollësi për kontrabandën e mallrave: “Në Leposaviq, më 21.03.2024, në 21:50 njësia policore ka ndaluar një veturë që drejtohej nga i dyshuari mashkull kosovar, i cili kishte hyrë nga Serbia në Republikën e Kosovës përmes rrugëve dytësore ku kishte të ngarkuara mallra të ndryshme (ushqimore dhe pije) për të cilat nuk

posedonte dokumentacion. Në konsultim me prokurorin vetura dhe malli i janë dorëzuar doganës ndërsa i dyshuari është liruar në procedurë të rregullt. Në magjistralen nga Jarinja ne Leshak, më 21.03.2024, është ndaluar vetura pikap me drejtues L.S., 23-vjeçar, gjatë kontrollit të veturës është vërejtur se ishte i mbushur me duhan. Policia në koordinim me organet e drejtësisë dhe doganën e ka trajtuar këtë rast”, ka njoftuar policia.



IKD-ja: Qeveria nuk përmbushi planin kaotik

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 22 MARS - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), me përkrahje të Rockefeller Brothers Fund, ka publikuar të premtën raportin “Prioritetet - që vazhdojnë të mos arrihen”.

Ky raport është rezultat i monitorimit të drejtpërdrejtë që IKD-ja i ka bërë Qeverisë së Kosovës gjatë vitit 2023. “Kreu i qeverisë kishte deklaruar se ‘Karakterit i planifikimit tregon për karakterin e qeverisjes’. Por, jostabiliteti i programit legjislativ i shprehur në ndryshimet e shpeshta të këtij programi, miratimi i projektligjeve jashtë planifikimit dhe moszbatimi i plotë i këtij planifikimi flasin për dështim të qeverisë në fushën e planifikimit qeverisës. Në programin e Qeverisë së Kosovës për vitin 2021-2025, qeveria proklamoi synimin për përgjegjshmërinë institucionale në planifikim dhe në zbatim. Kjo nuk u reflektua në programin legjislativ, i cili u karakterizua nga mos stabiliteti i tij. Brenda vitit 2023, ky plan u ndryshua plot 7 herë”, thuhet në këtë raport.

Për të vazhduar kështu, qeveria më tepër pati “planifikim dymujor” sesa planifikim vjetor legjislativ. “Madje, mosstabiliteti i Programit Legjislativ u shfaq menjëherë pas miratimit të tij. Kjo pasi qeveria e ndryshoi këtë plan vetëm gjashtë ditë pas miratimit të tij. Dështimi për përmbushjen e Agjendës Legjislative të vitit 2022 u bart në vitin 2023. Kjo pasi IKD-ja

gjen se 44% e agjendës legjislative për vitin 2023 është bartje e agjendës nga viti 2022. Këtu nuk bëjnë pjesë plot 26 Projektligje, nga miratimi i të cilave Qeveria u zbraps në vitin 2023, edhe pse planifikoj që të njëjtat t’i miratojë në vitin 2022”, është theksuar në raportin e KDI-së, duke shtuar se edhe pse programin legjislativ e miratoi me vonesë, qeverinë e ka karakterizuar jostabiliteti për t’iu përmbajtur programit legjislativ. “Ajo në shtatë raste ndryshoi këtë program dhe përkundër këtyre ndryshimeve ajo nuk arriti ta përmbushë në plotni programin legjislativ. Kështu, gjatë vitit 2023, Qeveria më tepër pati Agjendë Legjislative ‘dymujore’ se sa vjetore. Përkundër këtyre, Agjenda Legjislative e vitit 2023 nuk u përmbush. Qeveria e Kosovës, deri në fund të vitit 2023 arriti të realizojë 58% të programit legjislativ. Nga 99 projektligjet e planifikuara, Qeveria i miratoi vetëm 57 prej tyre, përdërsa 42 të tjera nuk janë miratuar. Qeveria miratoi edhe 21 projektligje të tjera jashtë planifikimeve në programin legjislativ. Kjo përqindje ka ardhur si rezultat i ndryshimeve të shumta të programit legjislativ. Me 8 nëntor kur kaloi më shumë se 83% e vitit, nga Programi Legjislativ u tërhoqën 25 projektligje të pamiratuara, ndërsa 34 projektligjeve iu ndryshua afati. Kjo lëvizje e qeverisë solli këtë rezultat. Kështu, pa këtë ndryshim, përqindja reale e zbatueshmërisë së planit legjislativ është 46%”, bëhet me

Efikasiteti i Qeverisë në realizimin e Programit Legjislativ për vitin 2023

Qeveria përmbushi 58% të agjendës së planifikuar për vitin 2023



Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) monitoron në vazhdimësi punën e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Të dhënat në këtë infografikë përfaqësojnë planifikimin nga muaji Janar - Dhjetor 2023 sipas programit legjislativ për vitin 2023.

Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovska Institut Pristina

Rockefeller
Brothers Fund
Rockefeller Foundation

Kjo infografikë është realizuar me mbështetjen financiare të RBF-së, përmbajtja e së cilës është përgjegjësi vetëm e IKD-së dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e RBF-së.

dije në raport. Ndërkaq në raport me planifikimet sipas afateve të përcaktuara në programin legjislativ, rezultojnë se nga 57 projektligjet e miratuara: 48 janë miratuar sipas planifikimit, ndërsa 9 projektligje janë miratuar duke mos e respektuar afatin e planifikuar. “Kështu, nëse shohim miratimin e projektligjeve dhe afatin e miratimit të tyre, përballë planifikimit të bërë, atëherë shohim se qeveria nuk përmbushi plotësisht dhe brenda afateve të parapara në agjendë legjislative 84% të agjendës legjislative”, vlerëson KDI. Sipas raportit të KDI-së, pos agjendës legjislative, qeveria

dështoi ta përmbushë planin e saj edhe në raport me miratimin e koncept-dokumenteve. “Deri në fund të vitit 2023, Qeveria e Kosovës ka miratuar gjithsej 17 koncept dokumente nga 36 sa kishte planifikuar. Shprehur në përqindje i bie se Qeveria ka përmbushur më pak se 50% të planifikimeve të saja në fushën e miratimit të koncept dokumenteve. Sa i përket projektligjeve të miratuara sipas programit legjislativ për vitin 2023 dhe të proceduara në Kuvendin e Kosovës, ky i fundit ka arritur të miratojë 34 nga 55 apo 62% e projektligjeve që i kanë plotësuar kushtet për t’u proceduar për miratim në lexim të dytë, që i bie

44% e totalit të ligjeve të dërguara në qeveri dhe vetëm 34% e ligjeve të planifikuara në agjendën legjislative të qeverisë për vitin 2023. Siç mund të shihet mos efikasiteti i qeverisë ka vazhduar edhe në Kuvendin e Kosovës. Për më tepër një përqindje e tillë u arrit falë miratimit në lexim të dytë të dhjetë projektligjeve me procedurë të përshpejtuar duke i shmangur afatet e përcaktuara procedurale”, theksohet në raport. Në këtë raport IKD-ja ka pasqyruar edhe shkeljet e Kushtetutës nga Qeveria dhe Kuvendi në ligjëbërje, e që në shumë raste gjetjet e IKD-së u konfirmuan edhe nga Gjykata Kushtetuese.

Binjakëzimi i Prishtinës me Kaohsiung të Tawanit hap dyert e bashkëpunimit ndërkombëtar

PRISHTINË, 22 MARS - Prishtina dhe qyteti Kaohsiung i Tawanit kanë nisur një kapitull të ri në marrëdhëniet ndërkombëtare duke u binjakëzuar zyrtarisht. Binjakëzimi mes dy qyteteve u shënua me nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit mes kryetarit të kryeqytetit, Përparim Rama dhe kryetarit të qytetit Kaohsiung, Chen Chi - mai,

për bashkëpunim ekonomik dhe industrial. Këto marrëveshje sinjalizojnë fillimin e projekteve të përbashkëta dhe shkëmbimin e njohurive dhe teknologjive. Po ashtu, u diskutua mundësia që kompanitë nga Prishtina ta zgjerojnë praninë e tyre në tregun aziatik përmes hapjes së hapësirave fizike në Kaohsiung. “Kjo lëvizje strategjike pritet ta lehtësojë

qasjen e kompanive të Prishtinës në tregun e gjerë Taiwanëz dhe t’i forcojë më tej lidhjet ekonomike dhe kulturore ndërmjet dy qyteteve”, ka deklaruar kryetari i Prishtinës, Përparim Rama. Ndërsa Qendra e Inovacionit në Kosovë (ICK) ka bërë hapa konkretë duke nënshkruar marrëveshje me Institute for Information Industry (III) dhe Megabay.



KDI-ja për Komisionin Hetimor për Rezerva: E përfundoi mandatin ende pa e filluar punën

EPOKA E RE
Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 22 MARS - Në seancën e 21 shtatorit të vitit 2023, me kërkesën e 41 deputetëve opozitarë dhe votën e 69 deputetëve, Kuvendi i Kosovës themeloi Komisionin Hetimor Parlamentar për t'i hetuar dyshimet mbi aferën korruptive në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, e njohur si "Rezervat shtetërore".

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka theksuar se që nga vendimi i Kuvendit, Komisioni është ndeshur me vështirësi për t'u funksionalizuar. "Deputetët e shumicës parlamentare, me pretekstin e 'mosvotimit të marrëveshjeve ndërkombëtare' nga subjektet opozitare, për më shumë se dy muaj bojkotuan mbledhjen themeluese duke pamundësuar fillimin e punës së komisionit. Për më tepër,

qasja e tyre edhe pas fillimit të pjesëmarrjes në mbledhje ishte penguese dhe në thelb joprofesionale. Ngjashëm, në dëmtimin e cilësisë së punës hetimore të këtij Komisioni, ka ndikuar edhe qasja e deputetëve opozitarë e mbizotëruar nga politizimi", është theksuar në reagimin e KDI-së.

Më tutje theksohet se me gjithë faktin që komisioni ka mbajtur 10 mbledhje, puna e tij në asnjë periudhë nuk ka përkuar me synimet e realizimit të një hetimi objektiv të bazuar në fakte, pasi ishte tërësisht i dominuar nga tendencat partiake dhe akuzat e ndërsjella. "Diskursi brenda komisionit ishte i rënduar me cilësime politike jo-parlamentare ndërmjet deputetëve dhe rrallëherë në frymën e trajtimit të temës për të cilën ky komision ishte formuar, pra hetimin e dyshimeve për



korupsion me rezervat shtetërore. Sot kur Komisionit hetimor parlamentar i përfundon mandati, ai akoma nuk ka arritur të ndërtojë një

plan të mirëfilltë të punës, pra nuk ka arritur të fillojë hetimet, fazë kjo që në Ligjin për Hetim Parlamentar vlerësohet të jetë faza fillestare e punës hetuese.

Për më tepër, tani kur kjo çështje është duke hetuar edhe nga Prokuroria Speciale, jo serioziteti, diskursi politizues dhe profesionalisht i mangët i këtij komisioni mund të cenoj vetë procesin hetues", është thënë në këtë reagim, duke theksuar tutje se Ligji për Hetim Parlamentar përcakton mundësinë e zgjatjes së mandatit të një Komisioni Hetimor edhe pas periudhës hetuese të kufizuar në afatin gjashtëmuor. "Porse, në kontekstin e Komisionit Hetimor për Rezerva Shtetërore, duke analizuar praktikën e deritanishme të vendosur përgjatë punës së këtij komisioni dhe faktin se lënda tashmë është në hetim nga organet e drejtësisë, mundësia e vazhdimit të mandatit vlerësohet jo e arsyeshme dhe jo produktive", është shkruar në reagimin e KDI-së.

Oda Ekonomike Amerikane reagon lidhur me ndërhyrjet politike ndaj institucioneve të drejtësisë

PRISHTINË, 22 MARS - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë ka shprehur shqetësimin e saj të thellë lidhur me suspendimin së fundmi të një përmbaruesi privat nga Ministria e Drejtësisë. Ky veprim, siç perceptohet nga Oda Amerikane dhe anëtarët e saj, përbën një shembull shqetësues të ndërhyrjes në proceset e pavarura gjyqësore të Kosovës.

Si avokuese prijëse për interesat e bizneseve dhe investitorëve në Kosovë, Oda Amerikane beson fuqishëm se sundimi i ligjit dhe pavarësia e gjyqësorit janë shtylla themelore për një mjedis të fortë dhe të favorshëm biznesi. "Është thelbësore të theksohet se sundimi i ligjit në thelb përfshin kufizimin e ushtrimit arbitrar të pushtetit duke iu nënshtruar kornizës së mirëfilltë ligjore", thuhet në reagim e Odës Ekonomike Amerikane.

Gjithashtu, Oda Amerikane shpreh shqetësimet lidhur me



sulmet verbale të përfaqësuesve të ekzekutivit dhe legjislativit ndaj pushtetit gjyqësor dhe institucioneve të drejtësisë, përfshirë Gjykatën Kushtetuese dhe gjykatat e tjera. "Sulmet e tilla gërryejnë më tej besimin në pavarësinë dhe integritetin e sistemit gjyqësor të Kosovës, i cili është thelbësor për sigurimin e procedurave të drejta dhe transparente ligjore për bizneset

dhe investitorët. Themelimi i funksionit të përmbaruesit privat, i mbështetur nga USAID-i, ka qenë instrumental në asistimin e institucioneve të Kosovës për ta përmirësuar përmbarimin e aktvendimeve civile, duke reduktuar në mënyrë dramatike numrin e lëndëve të pazgjidhura përmbarimore në sistemin gjyqësor të Kosovës. Ky funksion jo vetëm që rrit efikasitetin e

proceseve gjyqësore, por gjithashtu kontribuon në nxitjen e një mjedisi më të favorshëm për bizneset dhe investitorët, duke siguruar zbatimin në kohë dhe efektiv të vendimeve ligjore", thuhet në reagim.

Sipas Odës Ekonomike Amerikane, ndërhyrja e Ministrisë së Drejtësisë jo vetëm që i minon këto shtylla, por i kontribuon rritjes së paparashikueshmërisë dhe mungesës së transparencës rreth kuadrin ligjor dhe rregullativ të vendit dhe respektimin e normave dhe praktikave ndërkombëtare për përmbarimin e aktvendimeve të arbitrazhit ndërkombëtar. "Suspendimi i përmbaruesit, për herë të dytë, si vijimësi e rasteve të mëparshme të ndërhyrjeve të perceptuara, dërgon një sinjal shqetësues për investitorët vendas dhe ndërkombëtarë. Ai vë në dyshim garantimin e mbrojtjes ligjore dhe zbatueshmërisë së kontratave në Kosovë. Një klimë

e tillë e pasigurisë është e dëmshme për mjedisin e biznesit, duke penguar investimet, rritjen ekonomike e rrjedhimisht edhe përmirësimin e mirëqenies së përgjithshme. Dështimi për të respektuar ndarjen e pushteteve cenon parimet demokratike dhe proceset integruese euroatlantike. Respektimi i këtij parimi mbron nga përqendrimi i pushtetit si dhe mbron pavarësinë e institucioneve kyçe, përfshirë gjyqësorin", është thënë në reagimin e ODK-së.

Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë i bënë thirrje Ministrisë së Drejtësisë që t'i marrë parasysh implikimet më të gjera të veprimeve të saj në klimën e biznesit në Kosovë. "Rikonfirmimi i përkushtimit ndaj pavarësisë së gjyqësorit dhe sundimit të ligjit është imperativ për zhvillimin ekonomik dhe besimin e investitorëve", është thënë në reagim.

Ministria e Ekonomisë dhe IFC-ja nënshkruajnë marrëveshjen për zhvillimin e ankandit të erës

Prishtinë, 22 mars - Ministria e Ekonomisë dhe Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC) kanë nënshkruar marrëveshjen për zhvillimin e ankandit të erës.

Ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ka thënë se ky projekt shërben për krijimin e një sektori më të sigurt të energjisë në rast të sfidave që mund të hasen në këtë drejtim. "Po fillojmë ankandin e radhës. Ankandin e parë të erës prej 150 MW. Sapo nënshkruam marrëveshjen me IFC - International Finance Corporation për zhvillimin e këtij ankandi. Për tërheqjen e

investitorëve seriozë, kemi paraparë ndërtimin e rreth 150 megavatëve të erës, të ndara në dy lloje. Ofrimin e komponentës së partneritetit publiko-privat (PPP), për herë të parë në projekte të tilla në rajon. Ofrimin e marrëveshjes për blerjen e energjisë (PPA) përmes së cilës sigurohet çmimi i garantuar për një periudhë të caktuar (së paku 15 vjet). Sigurimin e deri në 80 milionë euro (të siguruar tanimë nga IMF) bashkinvestim që mund të shfrytëzohet përmes një partneriteti publiko-privat me investitorin (PPP). Projektin po

sigurohemi ta zhvillojmë e zbatojmë mbi baza konkurruese, në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare. Faleminderit IFC-së e USAID Kosovo për krijimin e partneritetit për të zhvilluar këtë projekt kyç e strategjik, e për gatishmërinë për të kontribuar në transformimin e sektorit tonë të energjisë", ka theksuar Rizvanolli.

Në anën tjetër, edhe menaxheri regional i IFC-së, Nicolas Marquier, ka theksuar se ky projekt është i rëndësishëm për zhvillimin e sektorit energjetik në Kosovë.



DOKUMENTE BRITANIKE PER DEMONSTRAT E VITIT 1981 NË KOSOVË (9)



Prof. dr. Sabit SYLA & Prof. dr. Hamit KABA

-19-

Për përdorim të kufizuar

A. E. Montgomery Esq
Ambasada britanike
Beograd
EESD
FCO
29 prill 1981
Inderuar Alan,
Jugosllavia/Shqipëria

1. Ka pasur një kthesë në rritje në spiralen e polemikës së rihapur ndërmjet Jugosllavisë dhe Shqipërisë mbi ngjarjet në Kosovë. Pa dyshim nuk duhet ta keni parë kryeartikullin e gazetës "Zëri i Popullit", i datës 23 prill, i cili prirë të bënte thirrje që Jugosllavia të reagonte. Shtypi parashikonte një përgjigje të fortë e cila për herë të parë erdhi më 27 prill në formën e një fjalimi të mbajtur nga Fadil Hoxha, anëtar i Kryesisë Federale të Kosovës para një grupimi aktivistësh të Partisë në Prishtinë. Së pari, ai trajtoi statusin e Kosovës brenda Federatës; së dyti trajtoi kritikën e Tiranës për prapambetjen ekonomike të Kosovës, dhe së treti, trajtoi marrëdhëniet Jugosllavi/Shqipëri. Më pas gazeta "Politika" ndërmori një kundërsulm përmes një artikulli të fuqishëm më 29 prill në vija të njëjta.

Statusi i Kosovës

2. Hoxha bëri një shpjegim shumë mbrojtës të statusit të Kosovës ku pasqyrohej e gjithë palogjikshmëria e pozitës Federative. Ai pohoi se forcimi dhe jo shpërbërja e Jugosllavisë kishte rëndësi i jetësore për shqiptarët e Kosovës që të arrinin barazinë e tyre të plotë kombëtare. Kjo ishte shkaktuar përmes statusit kushtetues të Kosovës si element përbërës i Federatës Jugosllave dhe pjesë integrale e Serbisë. Në realitetin e ndërluar të Ballkanit, që rezultoi nga zhvillimet historike, parullat që bënin thirrje për kalimin e Kosovës në Republikë në fakt u drejtuan drejt shkatërrimit të Jugosllavisë, realizimit të qëllimeve irredentiste të liga dhe rihapjes së çështjes së kufijve, e cila në Aktin Final të Helsinkit ishte vlerësuar si rrezik i madh për paqen në Evropë dhe në botë. Hoxha tha se ishte thellësisht i bindur se kjo nuk ishte në interesin e shqiptarëve të Kosovës, të cilët e dinin mirë se e kishin arritur lirinë dhe zhvillimin e tyre të plotë kombëtar dhe mund t'i pasuronin më tej ato, jo përmes konfrontimit me kombin serb dhe kombet e tjera të Jugosllavisë, por përmes bashkëpunimit dhe unitetit. Nëse duhej nxitur nacionalizmi për Shqipërinë e Madhe, kjo do t'i jepte shkas thirrjes për Serbinë e Madhe,

Bullgarinë e Madhe, Greqinë e Madhe dhe çdo lloj tjetër nacionalizmi në Ballkan, që lehtësisht do të bëhej bazë për forcat agresive në botë, për ta kthyer Ballkanin në një fuqi baruati.

3. Duke e justifikuar statusin e Kosovës si Krahinë Autonome, Hoxha tha se çdokush e dinte se ky status kishte ardhur si rezultat i "dëshirës së të gjitha kombeve dhe kombësive tona përmes vendimeve të marra nga Krahina, Republikat dhe Federata në vitet 1945 dhe 1946, pra përmes vendimeve të lira mbi bazën e dëshirës së shprehur të popullit të Kosovës si dhe kombit dhe kombësive të Serbisë që ne duhet të shoqërohemi së bashku në Serbi brenda Federatës". Krahina ishte tërësisht e barabartë dhe përgjegjëse për zhvillimin e saj, ndërkohë që i arrinte të drejtat e veta sovraane brenda Serbisë. "Prandaj", ai tha "as ne dhe askush tjetër në Jugosllavi nuk shohim nevojë për ndryshime në organizimin themelor të vendit tonë". Hoxha la jashtë rrëfimit të tij aspiratat e nacionalistëve shqiptarë, të cilët shohin vërtetë nevojën për ndryshim dhe të cilët do të kenë në mendje, siç e theksoi me mjeshhtëri gazeta "Zëri i Popullit", se ajo që është e mirë për maqedonasit duhet të jetë e mirë për shqiptarët. Prapambetja e Kosovës

4. Hoxha kaloi më pas në një argument më të sigurt për të hedhur poshtë thumbimet e Tiranës lidhur me zhvillimin ekonomik të Kosovës. Ai pyeti me ironi: "Nëse serbët supozohet se janë përgjegjës për prapambetjen e Kosovës, kush është përgjegjës për prapambetjen e Shqipërisë?". Ai theksoi se zhvillimi ekonomik i Shqipërisë ishte më i ulët në Evropë; se vetëm Prishtina kishte më shumë automjete, pajisje shtëpiake elektrike, televizorë dhe radio sesa Shqipëria; dhe se Kosova kishte dyfishin e studentëve të një popullsie që përbënte gjysmën e asaj të Shqipërisë.

5. Në një përpjekje të dukshme për t'ia kthyer Tiranës pretendimin e saj mbi të drejtën për t'u shqetësuar për shqiptarët e Kosovës, Hoxha tha se nëse duhej të ishte kështu, shqiptarët e Jugosllavisë duhet të kishin të njëjtën të drejtë të ishin të shqetësuar për vështirësitë dhe ngarkesat që mbartnin bashkëqytetarët e tyre në Shqipëri, veçanërisht mungesën e lirisë së udhëtimit të këtyre të fundit, qoftë brenda apo jashtë vendit të tyre. Marrëdhëniet Jugosllavi-Shqipëri

6. Hoxha e shprehu të gjithë këtë më shumë me dhimbje sesa me zemërim. Ai vazhdimisht i referohej keqardhjes së Jugosllavisë për situatën në Shqipëri, veçanërisht që populli në Shqipëri ishte aq i izoluar dhe i indoktrinuar për të pasur frikë nga fqinjët e vet. Ai e siguroi Shqipërinë se Jugosllavia nuk përbënte rrezik për të; se qëllimi i saj ishte që marrëdhëniet ndërmjet këtyre dy vendeve të ishin sa më të mira; dhe që Kosova duhej të ishte një faktor miqësie. Jugosllavia ishte

e përgatitur të kalonte mbështetjen pak a shumë të hapur ose të fshehtë të Shqipërisë për nacionalizmin e Shqipërisë së Madhe. Megjithatë ai bëri të qartë se ishte e papranueshme vënia në dyshim nga ana e Shqipërisë e kufijve që rezultoni nga Traktati i Londrës dhe Traktati i Versajës: Jugosllavia nuk do të lejonte askënd të kërcënojë kufijtë e saj. Ai i kujtoi Shqipërisë se Jugosllavia ende besonte në deklaratat e udhëheqësve shqiptarë se çdo sulm ndaj Jugosllavisë do të konsiderohej sulm ndaj vetë Shqipërisë! Megjithëse lëvizjet e fundit të Tiranës hedhin një hije të madhe dyshimi dhe pasigurie në marrëdhëniet midis tyre, Jugosllavia nuk do ta ndryshonte politikën e saj të fqinjësisë së mirë. Ai përfundoi duke bërë thirrje për vigjilencë ndaj çdo armiku dhe pohoi me vendosmëri se Jugosllavia nuk do të lejonte askënd që të luante me fatin e saj.

Komente

7. Fakti që Fadil Hoxha, arma më e madhe e Kosovës, është përdorur për t'iu përgjigjur gazetës "Zëri i Popullit" tregon seriozitetin me të cilin Jugosllavia shikon kritikën e Shqipërisë. Megjithëse deklarata e tij e rastit për Kosovën që të mbetet Krahinë Autonome në Federatë është e mbushur me mospërpulje, udhëheqja e ndjeu qartazi se duhej të thoshte diçka më shumë se deklaratat monotone të Dolanc dhe Dragosovac mbi pandryshueshmërinë e politikës. Sidoqoftë, vlen të përmendet se Hoxha e kaloi në heshtje atë që Tito i kishte thënë Enver Hoxhës në vitin 1946 se "Kosova dhe zona të tjera të banuara nga shqiptarët i përkasin Shqipërisë dhe ne do t'ju a kthejmë ato por jo tani pasi reagimi për Serbinë e Madhe nuk do ta pranonte një gjë të tillë". Nëse kjo është e vërtetë, dyshoj se jugosllavët do të preferojnë që ta ruajnë këtë të fshehtë sesa të hapin diskutim për marrëveshjet e arritura në atë kohë nga Tito për oportunitet të qartë politik.

I Juaji,
T. J. Clark

Për djëni: P. Rennie Esq
Departamenti i Kërkimit, FCO

-20-

Për përdorim të kufizuar

J C R Gray Esq
Ambasada britanike
Beograd
Departamenti Sovjetik dhe i Evropës Lindore
Zyra e Jashtme dhe e Komonuelthit,
29 prill 1981
I dashur Charles,

Kosova

1. Duhet thënë se nuk kalon asnjë ditë pa pasur ndonjë zhvillim të ri në jehonën e ngjarjeve në Kosovë. Nuk na lejohet ende të shkojmë aty që të shohim situatën, por një nga punonjësit tanë tregtarë të angazhuar në atë zonë më ka dhënë

përshkrimin e përvojës së tij nga një vizitë tregtare aty javën e kaluar.

2. Dushko Sokiç ka udhëtuar me makinën e tij për arsye regjistrimi për llogari të Beogradit, nga Shkupi në Prishtinë, dhe më pas në Mitrovicë dhe sërish në Beograd. Ai, si të gjithë udhëtarët e tjerë, u ndalua rreth 10 km larg Shkupit nga forcat e milicisë me helmata çeliku, por u lejua të kalonte pasi paraqiti kartën së tij të identitetit. Ai vuri re se dy makina me targa të huaja, ndoshta të Gastarbeiter me pushime, ishin ndaluar në anë të rrugës dhe u ishte kërkuar të prisnin. Ai u ndalua përsëri në periferi të Prishtinës nga policia e Malit të Zi (ai mund t'i dallonte nga aksenti) dhe përsëri u lejua të kalonte pa vështirësi. Ai dalloj police femra që kontrollonin pasagjeret femra në një autobus. Ai ndeshi pika të tilla të ngjashme kontrolli nga policia - pa postobloqe - gjatë rrugës së tij për në Prishtinë.

3. Në Prishtinë, lëvizja e njerëzve dhe automjeteve ishte pothuajse normale, megjithëse ai vuri se ana shqiptare e rrugës kryesore ishte më e qetë se zakonisht dhe kishte më pak njerëz në kafenenë kryesore. Hotelet nuk lejoheshin të pranonin të huaj pa leje të veçantë dhe, një shqetësim i madh për të zotët e hoteleve, ishte fakti se një delegacion i Bankës Botërore u refuzua që të pranoheshin në hotelin kryesor për një farë kohe, meqenëse nuk kishte njoftuar më përpara!

4. Sokiç foli me një numër zyrtarësh dhe biznesmenësh drejtues shqiptarë. Ato ishin të shqetësuar veçanërisht për faktin se udhëheqësit kryesorë të demonstratave nuk ishin kapur ende dhe spekulonin se do të kishte më shumë trazira më 4 maj, ditën e përvjetorit të vdekjes së Titos. Ato kritikuan me unanimitet Bakallin, për trajtimin që i kishte bërë situatës dhe që nuk i kishte kushtuar vëmendje paralajmërimeve të trazirave studentore nga Azem Vlasi, udhëheqësi i mëparshëm i rinisë, i cili aktualisht është në Kryesinë e Aleancës Socialiste të Kosovës. Vlasi, në përgjithësi, konsiderohej nga kontaktet e Sokiç si një figurë në rritje, megjithëse kam dëgjuar se në një mbledhje të kohëve të fundit të studentëve në universitet ai është quajtur "tradhtar", gjë që sugjeron se mund të ketë humbur mbështetjen e studentëve. Ai tha se problemi për heqjen pa zhurmë të Bakallit ishte se nuk ekzistonte më Tito për ta urdhëruar atë. Fadil Hoxha ishte shfaqur me reputacion në rritje dhe mendohej se ai ishte i vetmi njeri që mund të zgjidhte problemet e Kosovës.

5. Sidoqoftë, Kryesia e Komitetit Krahinor të Kosovës u mblodh më 27 prill dhe shqyrtoi shkaqet, rrethanat dhe pasojat e ngjarjeve të fundit "me një këndvështrim të veçantë kritik ndaj veprimeve të Lidhjes së Komunistëve të Kosovës dhe organizatave të tjera socio-politike dhe organeve të vetëmbrojtjes sociale në krahinë". Këtu ekziston mundësia që të përcaktohet përgjegjësia për

individë konkretë. Le të shohim.

I Juaji,
T. J. Clark
Për djëni: P. Rennie Esq
Departamenti i Kërkimit, FCO

-21-

Konfidenciale

GR 420
Fm Beograd 3101255Z APR 81
DIREKT PËR FCO
Kopje origjinale
Nr. tel. 056, datë 30 prill '81
Informacion për UKDEL NATO
Kopje Washington (FCO PSE PASS)

Kosova

1. Ka të dhëna se procesi i normalizimit të situatës në Kosovë nuk po shkon mirë siç do të donin autoritetet. Ka kaluar një muaj që prej demonstratave kryesore dhe Kosova është ende e mbyllur për të huajt, me përfshirje të atyre që punojnë në Kosovë; gjithashtu mbeten në fuqi masa të forta sigurie për të kontrolluar lëvizjen në këtë krahinë. Në një mbledhje të përbashkët të Kryesisë Federative dhe Këshillit Federativ për mbrojtjen e rendit kushtetues më 29 prill, Kolisevski tha se autoritetet nuk kishin zbuluar dhe shkatërruar ende forcat armiqësore që vepronin aty. U propozuan masa të mëtejshme konkrete për të përmirësuar sistemin e mbrojtjes së të gjithë njerëzve dhe vetëmbrojtjes sociale në krahinë.

2. Nga Kosova janë infiltuar raporte mbi mundësinë e demonstratave të mëtejshme gjatë fundjavës së ardhshme që përfshin festën e 1 majit dhe përvjetorin e vdekjes së Titos më 4 maj. Një pjesë e përmbajtjes së këtyre raporteve është dhënë nga një gazetë e Prishtinës e datës 30 prill, e cila konfirmoi aktivitetin e vazhdueshëm armiqësor dhe përmendi në mënyrë të veçantë rastin e përpjekjes së nxënësve të shkollës në një zonë 10 kilometra nga Peja, për të shpërndarë fletushka ku bënin thirrje për demonstrata të reja. Një lektor francez në Universitetin e Prishtinës, ka raportuar gjithashtu se 50% e studentëve po bojkotojnë universitetin.

3. Ka të dhëna se autoritetet janë vigjilente ndaj rrezikut dhe mund të pritët që të marrin të gjitha masat e mundshme paraprake për të evituar trazira të tjera. Sidoqoftë, ato duhet të jenë të shqetësuar se me gjithë përpjekjet e tyre të konsiderueshme deri më sot, duket se liderët kryesorë nuk janë kapur dhe janë ende në gjendje të organizojnë aktivitete armiqësore. Kryesia e Komitetit Qendror të Lidhjes së Komunistëve u mblodh më 29 prill për të shqyrtuar ngjarjet e ndodhura dhe përgatiti masat për kapërcimin e situatës aktuale që do të diskutohet në një mbledhje të komitetit qendror më 7 maj.

Bolland [Përsëritet sipas kërkesës]
Ky telegram nuk është përcjellë.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



MKRS-ja ndan 14.5 milionë euro për rinovimin e stadiumit 'Shahin Haxhiislami' në Pejë

PEJË, 22 MARS - Stadiumi "Shahin Haxhiislami" në Pejë do t'i nënshtrohet renovimit të tërësishëm. Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, ka njoftuar në "Facebook" se ka ndarë 14.5 milionë euro për rinovimin e tërësishëm të këtij stadiumi.

Sipas numrit një në MKRS, me të përfunduar hartimi i projektit zbatues të renovimit, do të shpallen procedurat për kontraktimin e operatorit për realizimin e punimeve. "Stadiumi i qytetit 'Shahin Haxhiislami' në Pejë do t'i nënshtrohet renovimit

të tërësishëm. Kemi ndarë 14.5 milionë euro për këtë qëllim, ndërsa me të përfunduar hartimi i projektit zbatues të renovimit do të shpallen procedurat për kontraktimin e operatorit për realizimin e punimeve", ka shkruar Çeku.



Foda debuton me fitore te Kosova, Shqipëria mposhtet nga Kili

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 22 MARS - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll ka shënuar fitore në ndeshjen miqësore ndaj Armenisë (0-1), e cila u zhvillua të premten në Yerevan. Kjo ishte ndeshja debutuese për përzgjedhësin e ri të "dardanëve", Franco Foda. "Kemi krijuar shumë raste, në përgjithësi ka qenë mirë. Në ndërtimin e lojës duhet të përmirësohemi. Kundërshtari kishte shumë raste në kundërsulme. Në të gjitha repartet duhet të përmirësohemi. Problemi i vetëm ishte në mesfushë, edhe në konkretizimin e rasteve duhet të punojmë sepse kishim shumë raste dhe nuk shënuam", ka thënë Foda, pas ndeshjes. Kosova ishte dominuese në pjesën e parë të ndeshjes, kurse golin e vetëm e shënoi në minutën e 25-të, kur Edon Zhegrova e goditi traversën dhe topi përfundoi te Rashica, i cili me qetësinë e duhur shënoi gol. Në pjesën e dytë, Kosova pati edhe dy raste të mira



shënimi që nuk i shfrytëzuan Muriqi dhe Rashica. Deri në fund rezultati mbeti i pandryshuar dhe Kosova regjistroi fitoren e parë në vitin 2024 dhe të parën me trajnerin Foda. Miqësoren e dytë për këtë muaj "dardanët" e zhvillojnë më 26 mars, në Budapest kundër Hungarisë. Shqipëria zhgënjën në testin e

parë miqësor në përgatitjet për pjesëmarrjen në "Euro 2024". Kuqezinjtë pësuan një humbje të thellë 0-3 në stadiumin e Parmës ndaj Kilit. Kilianët kaluan në avantazh në minutën e 19-të me Edouardo Vargas. Në pjesën e dytë, Sylvinho rezervon minuta edhe për Brojën, Mucollin dhe Hoxhën. Pikërisht Broja do të

krijonte një shans të artë në minutën e 72-të, por goditja ndalet nga Isla. Në minutën e 83-të, Marco Bolados shënon golin e dytë për Kilin, vetëm pak sekonda pasi zbriti në fushë. Në kohën shtesë, Kili shënoi dhe golin e tretë me Davilan. Shqipëria do të luajë të hënën testin e radhës miqësor ndaj Suedisë në Stokholm.

Distria, e bronzë në Gjeorgji

PRISHTINË, 22 MARS - Xhudistja e Kosovës, Distria Krasniqi, ka arritur ta fitojë medaljen e bronzë në Grand Slamin që po mbahet në Tbilisi të Gjeorgjisë. Sporti i xhudos vazhdon ta bëjë krenar shtetin e Kosovës, me suksese të mëdha në arenën ndërkombëtare. Kësaj radhe ishte xhudistja pejane Distria Krasniqi, e cila fitoi medaljen e bronzë në Grand Slamin e Tbilisit. Distria arriti të fitojë në finalen e repesazhit ndaj kinezes Yeqing Zhu, në kategorinë deri në 52 kilogramë. Fitorja e kampiones olimpikë erdhi pas një pike të shpejtë dhe një ippon në pas. Vlen të theksohet se Flaka Loxha u eliminua sot në xhiron e tretë, ndërsa nesër do të ndeshen edhe Laura Fazliu dhe Loriana Kuka.



Vëmendja në Pejë dhe Mitrovicë

PRISHTINË, 22 MARS - Java e 27-të e Prince Caffë Superligës, që zhvillohet në fundjavë, do të sjellë përballje interesante. Vëmendja do të jetë në Pejë dhe Mitrovicë. Xhironja do të hapet me një tjetër sfidë interesante ndërmjet Trepçës dhe Bashkimit. Dy skuadrat kanë siguruar "play-off"-in, me mitrovicasit që kanë blinduar vendin e parë me 24 fitore e dy humbje, kurse prizrenasit kanë 11 fitore e 15 humbje dhe

synojnë vendin e pestë në renditje. Dy rivalët e vjetër pritet të sjellin basketboll cilësor të shtunën në "Minatori". Po të shtunën zhvillohet përballja tjetër në mes të rivalëve të vjetër, Pejës dhe Sigal Prishtinës. Kampionët synojnë të mbesin në pozitën e dytë për t'u kualifikuar në gjysmëfinale, kurse prishtinasit ta fitojnë derbin dhe për t'u motivuar para garave vendimtare. Verdhezinjtë kanë 18 fitore dhe tetë humbje,



ndërsa bardhekaltrit 15 fitore e 11 humbje. Vëllaznimi pritet t'u kthehet fitoreve, pasi ndeshet me Istogun, që po paraqitet vetëm me vendorë. Kuqezinjtë kanë 11 fitore e 15 humbje, ndërsa istogasit një fitore e 25 humbje. Dueli i fundit është në mes të Proton Cable Prizrenit dhe Golden Eagle Yllit, ku prizrenasit do të luajnë në "play-out", kurse therandasit synojnë gjysmëfinalen e "play-off"-it. Basketbollistët prizrenas

SUPERLIGA - Java 27

Të shtunën takohen:
17:00 Trepça - Bashkimi
20:00 Peja - Sigal Prishtina

Të dielën takohen:
19:00 Vëllaznimi - Istogu
20:00 Proton Cable Prizreni - Golden Eagle Ylli

numërojnë shtatë fitore dhe 19 humbje, ndërsa ata therandas 17 fitore e nëntë humbje.

Rahoveci synon fitoren e 22-të rresht

RAHOVEC, 22 MARS - Me ndeshjen Rahoveci - Prishtina fillon xhironja e 22-të e Superligës së Kosovës në Hendboll (meshkujt). Kjo ndeshje zhvillohet të shtunën nga ora 20:00 në palestrën "Mizahir Isma" në Rahovec. Pasi e siguroi kalimin në gjysmëfinale të

Kupës, Rahoveci i kthehet garës kampionale me synim për fitoren e 22-të rresht. "Vrështarët" kanë fituar 21 ndeshjet e deritashme dhe udhëheqin në tabelë me 42 pikë. Prishtina udhëton me shpresë për ta befasuar Rahovecin dhe për të bërë një

hap të rëndësishëm drejt plejofit. Aktualisht është në pozitën e pestë me 18 pikë nga 20 ndeshje. Dy ndeshjet e tjera të xhiros së 22-të janë të dielën nga ora 19:00. Trepça e Kastrioti takohen në Mitrovicë, ndërsa Besa Fngas e Vushtrria luajnë në Pejë. Në Ligën

e Parë të hendbollistëve është xhironja e 12-të. Të shtunën janë ndeshjet: Drita-Llapi (15:00) dhe Prizreni-Samadrexha (19:00). Tri ndeshjet e së dielës janë: Vjosa-Dukagjini (19:00), Lepenci-Drenica (16:00), Istogu-Ulpiana (15:00).



Skuadra legjendë në Formula 1 do të garojë vetëm me një makinë në Australi pas aksidentit

VJENË, 22 MARS - Ajo që u përmend në orët e fundit tani është bërë realitet i hidhur. Në garën e Çmimit të Madh të Australisë, ditën e diel, do të marrin pjesë vetëm 19 makina në garë. Skuadra Williams ka vendosur ta tërheqë makinën e pilotit amerikan Logan

Sargeant, shasia e të cilit do t'i kalojë makinës së Alex Albon. Gjithçka rrjedh nga aksidenti që përfshiu shoferin tajlandez Albon në provat e lira të zhvilluara të premtën. Përplasja e tij e pengoi atë të merrte pjesë në sesionin e dytë të provave të lira, mbi të gjitha dëmtoi në

mënyrë të pariparueshme shasinë e tij. Skuadra e Williamsit ka ardhur në Melburn pa një shasi rezervë. Skuadra vendosi të garojë me pilotin e saj më të mirë, Albon, duke përjashtuar Sargeant nga kualifikimet dhe gara, edhe pse ai nuk ishte fajtor në këtë situatë.

"Na vjen keq që dëmtimi i shasisë na ka detyruar të tërheqim një makinë nga gara. Është e papranueshme në Formula 1 e sotme të mos kemi shasi rezervë. Si rezultat, na u desh të merrnim disa vendime shumë të vështira sot", thuhet në deklaratën e Williamsit.



Zeqiri shkëlqeu ndaj ish-skuadrës, shpallet MVP

PRIZREN, 22 MARS - Derbin e javës së 26-të të Prince Caffë Superligës e fitoi Bashkimi, duke mundur Sigal Prishtinës. Te prizrenasit më i miri ishte Lejson Zeqiri. Ai ndaj ish-skuadrës e mbylli ndeshjen me 26 pikë e nëntë kërcime. Zeqiri u shpall MVP i javës, ndërsa këtë çmim e fitoi edhe xhiron e kaluar. Trepça ka vazhduar formën e mirë, ndërsa sërish te mitrovicasit më i miri ishte Darnell Edge, duke e mbyllur ndeshjen ndaj Proton Cable Prizrenit me 24 pikë, gjashtë kërcime e shtatë asistime, kurse te prizrenasit më i miri ishte Ty Cockfield, i cili ndaj ish-skuadrës kishte 32 pikë, tri kërcime e katër asistime.

Golden Eagle Ylli fitoi ndaj Vëllaznimit, ndërsa te therandasit më i miri ishte Alonzo Verge Jr me



Top pesëshja

Lejson Zeqiri (Bashkimi) 26 pikë, 9 kërcime, / asistime, 29 indeksi
Darnell Edge (Trepça) 24 pikë, 6 kërcime, 7 asistime, 32 indeksi
Ty Cockfield (Proton Cable Prizreni) 32 pikë, 3 kërcime, 4 asistime, 29 indeksi
Alonzo Verge Jr (Golden Eagle Ylli) 23 pikë, 4 kërcime, 9 asistime, 25 indeksi
Sadio Doucoure (Peja) 18 pikë, 12 kërcime, 2 asistime, 30 indeksi

23 pikë, katër kërcime e nëntë asistime. Istogut, ku më i miri ishte Sadio Doucoure me 18 pikë e 12 kërcime dhe dy asistime. Peja shënoi fitore të pritur ndaj

REZULTATET

Orlando - New Orleans	121-106
Washington - Sacramento	109-102
Houston - Chicago	127-117
Milwaukee - Brooklyn	115-108
Dallas - Utah Jazz	113-97
Denver - New York	113-100
Phoenix - Atlanta	128-115

Milwaukee dhe Denveri vijojnë betejën për kreun, fitojnë Dallasi dhe Phoenixi



MILWAUKEE, 22 MARS - Milwaukee konfirmohet forca e dytë në Konferencën e Lindjes pas fitores me rezultat 115-108 ndaj Brooklynit. Lillard me 30 pikë e 12 asistime ishte më i miri në fushë për Bucksin, mbështetur

nga Antetokounmpo me 21 pikë. Në Perëndim, ekipi i Denverit fitoi me rezultat 113-100 ndaj New Yorkut, duke luftuar ende për vendin e parë në këtë kah të NBA-s. Nikola Jokiqi, protagonist me një "triple double" (30 pikë,

14 rebounde, 11 asistime), ndërsa Porteri realizoi 31 pikë. Fitoi edhe skuadra e Houstonit, që falë 26 pikëve të Greenit dhe 23 të Brooksit, mposhti me shifrat 127-117 Chicagon, duke i bërë të pavlefshme 35 pikët e Dosunmus për Bulls. Skuadra e Phoenixit, falë 30 pikëve të Bookerit, mundi me shifrat 128-115 Atlantant.

REZULTATET

Cleveland - Miami	104-107
Detroit - Indiana	103-122
Boston - Milwaukee	122-119
Toronto - Sacramento	133-116
Oklahoma - Utah Jazz	115-102
Golden State - Memphis	115-102
Phoenix - Philadelphia	115-102
Portland - Clippers	103-116

SHKURT

Enrique: Një ditë do të më pëlqente të rikthehesha në Barcelonë

Luis Enrique aktualisht është trajner i PSG-së, derisa ka folur për Kylian Mbappen, por edhe për mundësinë e një rikthimi të tij në krye të Barcelonës. Enrique e ka pranuar se dëshira e tij është që një ditë të rikthehet sërish në Barcelonë. "Nuk di asgjë për Mbappen, vetëm ai e di se çfarë do të bëjë. A do të rikthehem një ditë te Barcelona? Sot për sot jam i përfshirë totalisht te PSG-ja, vijoj të mësoj frëngjisht, shpresoj që shpejt ta flas. Kam pasur kontakte me dy klube angleze përpara se të vija te PSG-ja. Zgjidha të transferohem në Paris. Pastaj, sa për Barcelonën, nuk është një sekret, unë e kam thënë gjithnjë që një ditë do të më pëlqente të rikthehesha. Është shumë e vështirë që rrugët tona të bashkohen sërish", ka thënë Enrique.

Hoeness: Bayerni, Liverpooli dhe Reali janë të interesuar për Alonson

Presidenti i nderit i Bayern Munichut, Uli Hoeness, ka thënë se klubi i tij, Liverpooli dhe Real Madridi janë duke punuar për të nënshkruar me Xabi Alonson si trajnerin e ardhshëm. "Ai (Alonso) ka dëshmuar se mund të jetë trajner në një nivel të lartë. Klube si Liverpooli, Real Madridi dhe Bayerni po punojnë për këtë çështje", ka thënë presidenti i nderit i Bayernit. Thomas Tuchel do të largohet nga Bayerni, Jurgen Klopp do të largohet nga Liverpooli, ndërsa Real Madridi e ka një trajner, Carlo Ancelotti, por duket se po shikon mundësinë e ndryshimit.

Interi ka tri alternativa për mbrojtje

Skuadra e Interit ka filluar të mendojë për përforsime për edicionin e ri. Ëndrra e italianëve është Kim Min Jae i cili la Italinë në verën e shkuar kur kaloi nga Napoli drejt Bayern Munchenit. Interi ka raporte mjaft të mira me Bayernin, pasi më parë ka transferuar Sommerin dhe Pavardin. Dy alternativat e tjera për mbrojtjen zikaltër janë Smalling i Romës dhe Mavropanos i West Hamit.

Tre lojtarë do të largohen nga Liverpooli

Në fund të sezonit, Joel Matip, Thiago Alcantara dhe Adrian do të largohen nga Liverpooli. Sipas asaj që raportohet nga "Football Insider", "The Reds" beson se të tre lojtarët po kalojnë muajt e fundit në "Anfield" dhe nuk kanë ndër mend t'i rinovojnë kontratat e tyre përkatëse, të cilat skadojnë qershorin e ardhshëm. Drejtori i ri menaxhues Michael Edwards dhe drejtori i ri sportiv Richard Hughes duan ta rinovojnë skuadrën në element të ri dhe nuk do të paraqesin propozime për zgjatje të bashkëpunimit me futbollistë që janë mbi 30 vjeç.

Nëse Mbappe shkon në Real, largohet Rodrygo

Real Madridi pritet të bëjë ndryshime me afrimin e Kylian Mbappes gjatë merkatos së verës. Së fundmi raportohet se kalimi i francezit

në Spanjë do t'ia "hapte derën" një largimi të mundshëm të Rodrygos. Disa nga emrat më të mëdhenj të Premierë Ligë, siç janë

Manchester United, Manchester City, Liverpooli dhe Arsenali, kanë shfaqur interes të lartë për sulmuesin e Realit. Braziliiani ka kontratë

deri në vitin 2028 me madrilenët dhe klauzolë lirimi me vlerë një miliard euro. Sidoqoftë, nëse ai vetë do ta kërkonte transferimin, Real

Madridi do ta konsideronte ta linte të largohej, me kusht që klubet angleze të jenë gati të paguajnë të paktën 100 milionë euro në tavolinë.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “3Va’s” SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812056689 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “3Va’s” D.O.O. Pristine, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812056689 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “3Va’s” L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 812056689 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Luan Haliti shpall të pavlefshme certifikatën për Aftësim Profesional (QAP) Mitrovicë.

- Kevin Zenuni nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të sh.m.t. “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.

- Defrim Zeka nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.t. “Nexhmedin Nixha” Gjakovë

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulo CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



